

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një ish-oficer i Stasi-t, një ish-aktor filmash pornografikë dhe persona nën hetim për lidhje neo-naziste: K ush janë deputetët e rinj të AfD-së
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/nje-ish-oficer-i-stasi-t-nje-ish-aktor-filmash-grafike-d-he-persona-nen-i585525
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 06:58:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 07:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a7cf28da8ebfa7ae19daf8bc3c306f923151e661196d5cea5b6add4b812f3b45
TEKSTI	678144c48a7a3a6429e7e8a214aed3898cc907819c44ea431391cd856842479b
PAMJA	2af185840328e2a3d23b97ba0b68d56fffa192861ce9d3f46e2ebe80792f6fb0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fbe3c59adbb7335fb93218d26fcf1484fcd6fccea0e726658a1f6bd93df372e0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fbe3c59adbb7335fb93218d26fcf1484fcd6fccea0e726658a1f6bd93df372e0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e Arabia Saudite mbvll tubacionin krvesor te naltës pas sulmit me drone nga IrakuPerparimi i Hutheve ne Jemen rrit rrezikun ne Detin e Kuq ,analistet: F-itimet territoriale mund te jene te veshtira p fundit

Një ish-oficer i Stasi-t, një ish-aktor filmash pornografikë dhe persona nën hetim për lidhje neo-naziste: Kush janë deputetët e rinj të AfD-së

12 Shtator 2026, 09:30Bota TEMA



Një ish-oficer i Stasi-t, një ish-aktor filmash pornografikë dhe

Pas fitores historike të partisë së ekstremit të djathtë, AfD në landin e Saksoni-Anhalt, vëmendja në Gjermani është zhvendosur te profili i disa prej deputetëve të rinj të partisë. Sipas [The Guardian](#), mes 39 të zgjedhurve të AfD-së në parlamentin e landit ka një ish-oficer të Stasi-t, një ish-aktor filmash pornografikë, persona nën hetim për lidhje me organizata neo-naziste dhe figura me lidhje pro-Kremlinit.

Një prej deputetëve të sapozgjedhur, 78 vjeç, ka pranuar se ka punuar për Ministrinë e Sigurisë së Shtetit të Gjermanisë Lindore, Stasi, ku merrej edhe me qytetarët që kërkonin të arratiseshin nga RDGJ-ja. Përzgjedhja e tij e tij është kritikuar nga organizatat që përfaqësojnë viktimat e diktaturës komuniste.

The Guardian shkruan gjithashtu se një tjetër deputet i AfD-së rezulton të ketë luajtur më herët në filma pornografikë dhe është dënua për vjedhjen e një sasie të madhe çarçafësh dhe materialesh të tjera nga një hotel. Ai është përfshirë edhe në një çështje lidhur me falsifikimin e dokumenteve shkollore, megjithëse pretendon se më pas është rikthyer në universitet pas një beteje ligjore.

Dy deputetë të tjerë janë nën hetim për dyshime se kanë tentuar të vazhdojnë veprimtarinë e Artgemeinschaft, një organizatë neopagane e ekstremit të djathtë, e ndaluar nga autoritetet gjermane dhe e lidhur me ide nacionaliste e antisemite. Njëri prej tyre po hetohet gjithashtu për një çështje që lidhet me armët. Të dy i mohojnë akuzat.

Sipas raportimit, hetime të mediave gjermane kanë zbuluar gjithashtu lidhje të disa figurave të AfD-së me organizata të tjera të ekstremit të djathtë, përfshirë grupin tashmë të ndaluar "Homeland-Loyal German Youth". Mes personave të lidhur me grupin parlamentar është përmendur edhe një këshilltar që ka shkruar një biografi të përkthuar si një "homazh ndaj nacional-socializmit".

Në listën e deputetëve të rinj ka edhe figura me lidhje pro-ruse, si dhe persona që kanë zhvilluar kontakte me lëvizjen MAGA në Shtetet e Bashkuara. AfD-ja ka premtuar kufizim të fortë të emigracionit dhe rivendosjen e marrëdhënieve më të afërta me Moskën.

Kreu i grupit parlamentar të AfD-së në land, Ulrich Siegmund, reagoi me ironi ndaj pyetjeve për biografitë problematike të deputetëve, duke i quajtur dy prej tyre "djemtë e këqij" dhe duke thënë se partia do të presë përfundimin e hetimeve përpara se të marrë një qëndrim.

Edhe vetë Siegmund është përfshirë në polemika pasi, duke folur për hapjen e një fabrike izraelite armësh në land, lidhi nevojën për prodhim armësh me ofensivën e planifikuar të AfD-së për "riemigrim" dhe dëbime. Socialdemokratët e akuzuan se po përdorte një gjuhë që sugjeronte dhunën si mjet politik.

AFD fitoi afro 44% të votave në Saksoni-Anhalt dhe 39 vende në parlamentin me 83 deputetë, duke mbetur vetëm tre mandate larg shumicës absolute. Deri tani, partitë tradicionale kanë refuzuar të bashkëpunojnë me të, ndërsa protesta kundër AfD-së janë planifikuar në më shumë se 20 qytete gjermane.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Arabia Saudite mbyll tubacionin kryesor të naftës pas sulmit me dronë nga Iraku](#)

08:50 Bota

[Përparimi i Huthëve në Jemen rrit rrezikun në Detin e Kuq, analistët: Fitimet territoriale mund të jenë të vështira për t'u përmbysur](#)

08:40 Bota

[Britania rrëzon projektligjin për vdekjen e asistuar, 286 deputetë votojnë kundër](#)

08:30 Bota

[Franca përfshihet drejtpërdrejt në projektin energjetik Greqi-Qipro, Mitsotakis dhe Macron koordinojnë lëvizjet e radhës](#)

08:10 Bota

[Putin paralajmëron Evropën: Trupat evropiane në Ukrainë do të nënkuptonin luftë me Rusinë](#)

07:42 Bota

[Dokumentet sekrete të "11 shtatorit"/ Trump deklasifikon 100 faqe, ku flitet për kërcënimet e Al Qaeda](#)

07:28 Bota

[BE nuk fal abuzimet, kërkon rrjete sociale më të sigurta për të miturit](#)

22:30 Bota

[25 vjetori i sulmeve të 11 shtatorit/ Ambasada amerikane në Tiranë nderon 2,977 viktimat: Nuk do ta harrojmë kurrë](#)

22:10 Bota / 1 koment

[Kremlini paralajmëron Lituaninë: Do jesh në shënjestër të Rusisë nëse instalon armë bërthamore](#)

22:02 Bota / 2 komente

[Sulmohet tubacioni i naftës në Arabinë Saudite, shpërthejnë zjarre në disa pika](#)

21:21 Bota / 2 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javen e fundit

PROFIL: Kush është ministri i ri i Brendshëm?

10:40 Kronika / 74 komente

Genti Tare: SPAK bëri show me Igli Taren, e mbajti 6 orë ...

10:50 Politika / 52 komente

PISA, hakmarrja europiane për mësueso-fobët shqiptarë

16:18 Politika / 39 komente

Audiopërgjimi i Ahmetajt dhe akuzat për trafik armësh, qe...

11:15 Politika / 74 komente

Nga ndërhyrja te Trump, te Samiti i NATO-s! Thaçi për Ram...

11:30 Politika / 36 komente

Blog Tema

Haga, midis maktheve dhe paranojave

21:25 Blog / 1 koment

Haga, midis maktheve dhe paranojave

21:00 Blog / 1 koment

Parku i Liqenit me syte nga qielli dhe SPAK

19:26 Blog / 7 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

REGJISTROHU

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

- 
- 
- 
- 
- 

Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.